This programme is funded by the European Union

# Fund Dhunës ndaj Vajzave dhe Grave nga Grupet e Pafavorizuara:

## Vajzave dhe Grave me Aftësi të Kufizuara, Vajzave dhe Grave nga Minoriteti Rom dhe Egjiptian, Vajzave dhe Grave nga Komuniteti LGBTI



Tiranë, Qershor 2018

Për të kërkuar ndihmë telefononi në:

TELEFON: **129** ose **112**
TELEFON: **0800 98 88**
(Vetëm në Tiranë dhe Durrës)

TELEFON: **116 117**
TELEFON: **04 2259-388**
TELEFON: **042431077 / 042431078**

## Ky udhëzues shërben për të informuar vajzat dhe gratë e grupeve të pafavorizuara:

*a) Mbi dhunën dhe format e dhunës;*
*b) Shërbimet për parandalimin, mbrojtjen dhe rehabilitimin nga dhuna;*

## 1. Ku ndodh dhuna?

### në publik



### në jetën private



**Dhuna mund të ndodhë:**

**në shtëpi**



**në vendet e punës**



**në shkolla**



**në institucione**



**në komunitet**

## 2. Cilat janë disa nga format e dhunës?

Ka disa forma të ndryshme të dhunës, një person mund të jetë subjekt i më shumë se një forme.

***Abuzimi fizik:***
Rrahje, goditje, shkundje, shtyrje, mbytje, kafshime, djegie, shkelmime, ose sulme me armë, izolim.



***Abuzimi dhe shfrytëzimi seksual (përfshirë përdhunimin):***
Të gjitha format e agresionit seksual, ngacmimit seksual ose shfrytëzimit seksual, taktika poshtëruese, për të ulur, kontrolluar ose kufizuar seksualitetin e personave, ose zgjedhjet për riprodhim përbëjnë abuzim seksual.



***Abuzimi emocional:***
Sulme verbale, si bërtitje, këlthitje, fyerje (etiketime), izolim nga shoqëria, ose frikësim. Kanosje për dhunë dhe për marrje të fëmijëve.



***Abuzimi ekonomik ose financiar:***
Mosdhënia e parave që janë të domosdoshme për të blerë ushqim apo trajtim mjekësor.



***Martesat e padëshiruara:***
Martesë e detyruar është ajo martesë që bëhet pa dëshirën ose pa pëlqimin e njerës palë ose të dy palëve. Martesë e detyruar mund të ndodhë kur anëtarë të familjes ose të tjerë ushtrojnë dhunë psiqike ose fizike, kërcënime për t'u detyruar të martoheni kundër dëshirës suaj.



***Përndjekja:***
Përndjekja (sjelljet kërcënuese) lidhet me përfshirjen e qëllimshme e të vazhdueshme të individit në sjellje kërcënuese drejtuar ndaj një personi tjetër, që i shkakton frikë për sigurinë personale.



Gratë kanë më shumë gjasa të përjetojnë dhunë fizike, seksuale, psikologjike dhe ekonomike, sesa meshkujt..



Gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara përjetojnë dhunë gjinore në nivele shumë herë më të larta, dhe në forma të shumëfishta e unike për shkak të diskriminimit dhe stigmës në bazë të gjinisë dhe aftësisë së kufizuar.



E njëjta gjë mund të thuhet edhe edhe për vajzat dhe gratë e minoritetit Rom dhe Egjyptian dhe komunitetit LGBTI.



## *Cilat janë format e veçanta të dhunës ndaj vajzave dhe grave me aftësi të kufizuara?*

Gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara janë subjekt i një diskriminimi të shumëfishtë ku përfshihen:

Largimi i mjeteve ndihmëse, karrikes me rrota, shkopit për të verbërit, aparate dëgjimi, mjete që ndihmojnë ngritjen nga shtrati etj.



Abuzim me ilaçet (me tepricë; me pakicë ose mosdhënia e tyre.)



Prekje të papërshtatshme gjatë dhënies së kujdesit.



Presion për mos-ofrim shërbimi/ asistence nëse nuk pranon të kryejë marrëdhënie.



Sterilizimi i detyruar; Përdorimi i detyruar i kontraceptivëve; Abort i detyruar.



Abuzimi/etiketimi duke përdorur aftësinë e kufizuar në vend të emrit.



Detyrimi të lyp, kërkojë ndihmë, ushqim, para.



Vjedhja ose marrja e kontrollit të parave.



Përdorimi i pagesave të aftësisë së kufizuar për nevoja të tjera familjare dhe për anëtarë të tjerë të familjes.



Refuzimi i blerjes së ilaçeve esenciale ose paisjeve që lidhen me aftësinë e kufizuar.



### *Dhunë institucionale*

- Dhuna ndaj grave mund të lejohet me ligj ose të kryhet nën autoritetin e shtetit:

a) grave me aftësi të kufizuara, veçanërisht me aftësi të kufizuara intelektuale ju mohohet me akte ligjore dhe nënligjore e drejta për akses në shërbimet e ngritura për të mbrojtur gratë nga dhuna;

b) në institucione, gratë me aftësi të kufizuara i nënshtrohen formave të shumta të dhunës dhe diskriminimit;

c) Institucionalizimi i detyruar përbën një formë të dhunës.

d) Trajtimet mjekësore në institucione pa pëlqimin e informuar ju mohon grave me aftësi të kufizuara vendimarrjen



- Mungesa e përshtashmërisë ndërtimore, por edhe përshtatjes në procedura (mungesa e përkthyesit të gjuhës së shënjave), mungesa e informacionit të thjeshtëzuar e me shkrim të zmadhuar, mungesa e informacionit në audio/me titra, heqja e të drejtës për të marë vendime vetë ju mohon aksesin në drejtësi vajzave dhe grave të dhunura me aftësi të kufizuara









## *Cilat janë format unike të dhunës ndaj vajzave dhe grave nga komuniteti rom dhe egjiptian?*

Tërheqja e vajzave nga shkolla sapo arrijnë moshën e pubertetit pa pëlqimin dhe kundër vullnetit të tyre.



Martesat e hershme - të cilat shpesh gjenerojnë të gjitha format e dhunës të ushtruara jo vetëm nga bashkëjetuesi por dhe familja e tij.



Detyrimi/imponimi për të lypur në rrugë, bare, dhe vende turistike si edhe për ushtrim prostitucioni në këto vënde.



Dhunë verbale përmes etiketimit për shkak të përkatësinë etnike.



Dhunë psikologjike, ekonomike dhe fizike në rrugë dhe institucione, përfshirë në shërbime.



## *Cilat janë format unike të dhunës ndaj vajzave dhe grave nga komuniteti LGBTI?*

Dhunë psikologjike për shkak të stigmatizimit që gratë lesbike dhe biseksuale ndeshin në shoqëri.



Martesa të detyruara / imponuara të grave lesbike dhe biseksuale nga familja.
Martesa që femrat lesbike detyrohen të bëjnë me meshkuj homoseksual, të detyruara / imponuara nga presioni familjar dhe shoqëror.



Abuzim dhe dhunë verbale dhe fizike, përfshirë kërcënim dhe izolim në familje nga familjarët kur ata zbulojnë orientimin seksual të grave lesbike.



Trajtim mjeksor kundër vullnetit dhe dëshirës, me imponim nga familjarët për t'i kuruar vajzat e tyre me kura hormonale të cilat sjellin pasoja shumë të dëmshme për shëndetin.



Dhunë në institucionet arsimore, ngacmim dhe abuzim verbal dhe fizik jo vetëm nga nxënësit e tjerë por dhe nga vetë mësuesit për grate dhe vajzat e komunitetit lesbik, biseksual dhe transgjinor (LBT).



Gratë transgjinore shpesh janë viktima të krimeve të urrejtjes, përjetojnë dhunë, abuzime nga policia dhe përjashtohen nga shërbimet shëndetësore.



Mohimi i të drejtës për strehim për gratë transgjinore, dëbimi nga shtëpitë, ndonjëherë edhe me dhunë, pamundësi për të marë ambjente me qira.



## 3. Cilat janë masat që garanton ligji për tu mbrojtur nga dhuna?

Janë një sërë ligjesh që i mbrojnë vajzat dhe gratë, përfshirë vajzat dhe gratë nga grupet e pafavorizuara nga ngacmimi, dhuna dhe abuzimi, ndaj **DHUNA** duhet të **DENONCOHET**.

Sipas Ligjit kundër dhunës në familje, gjykatat civile mund të vendosin masa mbrojtëse për viktimat përmes një procedure të shpejtë, të përballueshme dhe të thjeshtë.

**Urdhri i mbrojtjes dhe Urdhri i menjëhershëm i mbrojtjes** japin mundësi për të marrë masa për të mbrojtur veten nga dhuna. Ata mund t'ju sigurojnë lehtësim, duke e urdhëruar personin dhunues:

- *që të mos kryejë ose të mos kërcënojë se do të kryejë dhunë në familje*
- *që të largohet menjëherë nga banesa;*
- *që të mos 'i afrohet shtëpisë, vendit të punës, banesës, shkollës së fëmijëve, ose vendeve të cilat frekuentohen më tepër nga viktima;*
- *që të paguajë qeranë e banesës si dhe detyrimin ushqimor për viktimën, fëmijët apo pjesëtarë të tjerë të familjes që ka në ngarkim;*
- *Urdhërat e mbrojtjes vendosin menjëherë viktimën/at dhe të miturit në strehime të përkohshme, etj.*

Kërkesa për një urdhër mbrojtje bëhet në ÇDO KOHË në ÇDO GJYKATË CIVILE (seksioni i familjes). Orari i gjykatave të rrethit është nga e hëna në të premte, ora 08:00 - 16:00.

Masa të tjera garantohen nga Kodi Penal: Kodi penal njeh si vepër penale:

1. *ngacmimin seksual dhe parashikon dënim me burgim deri në 7 vjet;*
2. *dhunën seksuale dhe parashikon dënime deri në 25 vjet;*
3. *martesat e detyruara-pengim ose shtrëngim për martesë, dhe parashikon dënim deri në 3 muaj;*
4. *përndjekjen(në ambjente publike apo private) dhe parashikon dënim deri në 4 vjet;*
5. *abortin e detyruar dhe parashikon dënim me gjobë ose burgim deri në 5 vjet*

## 4. Ku të drejtohen vajzat dhe gratë e grupeve të pafavorizuara për të kërkuar ndihmë për të parandaluar, për tu mbrojtur dhe rehabilituar nga dhuna?

Pranë Komisariatit më të afërt të policisë në vendin ku ndodheni; Numri i telefonit **129** ose **112**; Tirane, Elbasan, Shkoder, Vlore.



Pranë njësisë së pushtetit vendor (bashki, njësi administrative); Numri i telefonit **0800 98 88** (Vetëm për Tiranë Durrës)



Pranë Qendrës më të afërt shëndetësore në vendin ku banoni apo ndodheni;



Pranë Linjës Kombëtare të Këshillimit për Gra dhe Vajza: Numri i telefonit **116 117.**



Pranë Zyrës së Ndihmës Ligjore – Zyra e Koordinimit për trajtimin e rasteve të dhunës në familje, Ministria e Drejtësisë, Tel: **+355 4 2259-388**;



Pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi; Tiranë, Tel: **042431077; 042431078**



Pranë çdo bashkie, pranë zyrës së shërbimeve sociale ka një koordinator vendor për dhunën në familje ose administrator shoqëror që bën referimin e rasteve të dhunës në ekipin teknik ndërdisiplinor të ngritur në bashki

Koordinatori vendor për dhunën ju ndihmon të përgatisni dhe

paraqisni kërkesat për urdhra mbrojtës.
Koordinatori vendor për dhunën ju  ju shoqëron në gjykatë, polici apo për shërbime të tjera të domosdoshme për rastin tuaj.
Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve pranë Bashkisë ju ndihmon nëse të dëmtuar nga dhuna janë vajza të mitura.

Çdo organ që merr informacion për rastin tuaj ju ndihmon/drejton tek strukturat përkatëse që të plotësoni kërkesë-padinë me të cilën i drejtoheni gjykatës në mënyrë që kjo e fundit të lëshojë një urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje.

Në ndihmë ju vijnë edhe organizata jofitimprurëse të cilat mund të ofrojnë këshillim, por edhe e referojnë rastin te autoritetet shtetërore për një ndihmë të shpejtë dhe efikase.

**Tiranë**
***Qendra Për Nisma Ligjore dhe Qytetare, QNL***
Rr. Vaso Pasha, pall.12, Shk.1, Ap.1.
Tel: +355042259795;
Cel: +355; 0682031447
E-mail: avokatore@albmail.com;
avokatore2@yahoo.com
*Shërbimet: Asistence ligjore, përfaqësim në Gjykatë*

***Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza***
Adresa: Rruga Muhamet Gjollesha Pall.73 Shk.1-Tiranë
Tel: 04 22 33 408
Nr. Pa pagesë 08004020; 08009888
Email: info@hotlinealbania.org
*Shërbimet: Linjë këshillimi psikoemocional , asistencë ligjore, strehim, formim profesional për viktimat e dhunës ndaj gruas*

***Qendra pwr tw Drejtat e Njeriut nw Demokraci, QDNJD***
Adresa: Rruga “Siri Kodra”, Nd 13, H 9 , Ap 12 , Njësia 9, Kodi Postar 1017
(Pallati Big Market), Tiranë;
Tel/Fax : ++355 4 2 400 712
Email: info@hrdc.al;
qdnjd@albaniaonline.net
*Shërbimet: Këshillim ligjor, përfaqësim në Gjykatë, hartim dokumentacioni ligjor*

***Qendra Komunitare Sot për të Ardhmen***
Rruga Elbasanit, Abau Building, H.2/Ap.13h;
Tel/fax: +355 (4) 230 24 10
Linja: 0 800 98 88
Telefon:+ 355 69 40 94 622
*Shërbimet: Shërbim psikologjik dhe ligjor për viktimat e dhunës*

***Res Publika***
Adresa: Gjykata e Tiranës, Bulevardi “Gjergj Fishta”, Tiranë

Tel: 069 557 9251
*Shërbimet: Këshillim dhe përfaqësim në proceset gjyqësore penale, civile dhe administrative, në të gjitha shkallët e gjykimit, përfshirë këtu Gjykatën Kushtetuese dhe Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, për kategoritë vulnerabël dhe viktimat e dhunës me bazë gjinore.*

***Shërbimi Ligjor Falas, TLAS***
Adresa: Bulevardi "Bajram Curri", Pallatet
Agimi, Shk.18, Ap.322, Tiranë
Tel: + 355 4 2253113;
Tel/Fax: + 355 4 2258442
E-mail: tlas@tlas.org.al
*Shërbimet: Këshillim dhe përfaqësim në Gjykatë ku mbulohen edhe shpenzimet gjyqësore për kategoritë e margjinalizuara*

***Organizata Të Ndryshem dhe të Barabartë***
Adresa: Rruga Milto Tutulani, Pallatet Alb-Milenium, Shk.6, Ap.30,36 Tiranë
Tel.00355 4 2221892,
Cel. 00355 69; 20 88 696
Email: diff erent&equal@icc-al.org
*Shërbimet: Riintegrimi i viktimave të trafikimit dhe fëmijëve të tyre përfshirë shërbime rezidenciale dhe komunitare*

**Në ndihmë ju vijnë edhe organizata që punojnë punojnë për grupet e pafavorizuara**

**Tiranë**

**Organizata që punojnë për Komunitetin Rom dhe Egjiptian**

***Gruaja rome e të nesërmes - Tiranë***
Celular: 069 7757740
E-mail: meleqe.rrenja@gmail.com
*Shërbimet:Përmirësimi i statusit social arsimor i fëmijëve romë në arsimin parashkollor dhe rritja e ndërgjegjësimit në fushën e edukimit*

***Qendra për të Drejtat e Grave Rome*** - operon në të gjitha qytetet me përqëndrim të konsiderueshëm të minoritetit rom
Celular: 069 6948040
E-mail:
romaëomanrights@gmail.com
*Shërbimet: Përmirësimi i statusit të grave rome në familje dhe shoqëri.*

***Çatia e Grave Rome***
Celular: 068 5350 315
E-mail:
catiaegruasrome@gmail.com
*Shërbimet: Përfshirja sociale dhe ekonomike e komuniteteve Rome dhe Egjiptiane*

**Organizata që punojnë për Komunitetin LGBTI**

***Aleanca kundër diskriminimit LGBTI***
Adresa: Rr. "Mine Peza", Private Nr 75, Tiranë
Celular: 0696484490
E-mail: aleanca.al@gmail.com
info@aleancalgbt.org
web: www.aleancalgbt.org
*Shërbimet: Krijimi dhe fuqizimi i*

*komunitetit shqiptar LGBTI, mbrojtja e të drejtave të tij dhe lufta kundër diskriminimit të bazuar tek orientimi seksual dhe identiteti gjinor.*

***Qendra Streha***
Adresa:  Rruga "Rr.Naim Frasheri", Nr. 75, Tiranë
Celular: 0672195736
E-mail: strehalgbt@gmail.com
web: www.strehalgbt.al
*Shërbimet : Qëndër rezidenciale në ndihmë të të rinjvve nga komuniteti LGBTI me nevoja emergjente strehimi.*

***OMSA Open Mind Spectrum Albania***
Adresa: Rr. Mihal Grameno, P. 010, Shk. 1, Ap. 6, Tiranë
Tel: 0693953920
E-mail: omsa.albania@gmail.com
web: www.omsalbania.org
*Shërbimet: Punë në komunitet dhe advokim*

***Pink Embassy***
Tel: 04 2265741
E-mail: pinkembassy@crca.al
info@pinkembassy.al
web: www.pinkembassy.al
*Shërbimet : Mbrojtja dhe avancimi i të drejtave të komunitetit LGBTI në Shqipëri.*

## Organizata që punojnë në fushën e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara

***Shoqata e Invalidëve të Punës të Shqipërisë***
Adresa: Bulevardi Dëshmorët e Kombit
Tel.: 003552250325
Celular: 0692037439,
E-mail: ship@abissnet.com.al
*Shërbimet: Përmirësimi i statusit social dhe ekonomik, rehabilitimi dhe integrimi i Invalidëve të Punës*

***Shoqata Kombëtare në ndihmë të handikapëve mendore***
Adresa: Rr. A.Moisiu pranë Kinostudios, Tiranë
Nasi Duka
Celular: 0682084945;
E-mail: centervduka@albmail.com;
*Shërbimet: mbrojtja dhe integrimi social i personave me aftësi të kufizuara mendore;*

***Shoqata Kombëtare e Para dhe Tetraplegjikëve***
Adresa: Rr. e Durrësit, Ish Uzina Enver, Tiranë
E-mail: para_tetra@yahoo.com
*Shërbimet: rehabilitimi dhe integrimi i personave para dhe tetraplegjikë*

***Shoqata Kombëtare e të Verbërve***
Adresa: Rr. Nikolla Lena
Tel.: 00355259611
Celular: 0682180896
E-mail: stafaj@yahoo.com
*Shërbimet: Rehabilitimi dhe Integrimi i të Verbërve*

***Shoqata Kombëtare Shqiptare e Njerëzve që nuk Dëgjojnë (ANAD)***
Celular (vetëm mesazhe): 0683186043

E-mail:
anad.coordinator@gmail.com
web: www.anad.al
*Shërbimet: lehtëson proçesin e përfshirjes së personave që nuk dëgjojnë në shoqërinë shqiptare duke rritur ndërgjegjësimin e qeverisë dhe fuqizimin e komunitetit të personave që nuk dëgjojnë*

***Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara***
Adresa: Rr. Bogdani, Nr 1, Tiranë
Tel.: 0035542269426;
E-mail: adrf@albmail.com
*Shërbimet: Avokati; asistencë teknike; qendër informacioni dhe trajnimi; këshillim ligjor, përfaqësim në Gjykatë, hartim dokumentacioni ligjor për personat me aftësi të kufizuara; Fuqizim Ekonomik për Njerëzit me Aftësi të Kufizuara përmes Punësimit.*

***Shoqata Ndihmoni Jetën***
Adresa: Rr. "Hoxha Tahsim" Vila 187/1, Tiranë
Celular: 0682084945
E-mail:
aferditaseiti@helpthelife.org.al
*Shërbimet : Qendër ditore e shërbimeve sociale për fëmijë dhe të rinj me aftësi të kufizuara intelektuale. Advokaci për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara mendore, fëmijët dhe adoleshentët. Shërbim komunitar në banesë. Shërbime psiko-edukative për fëmijët me crregullime të spektrit të autizmit. Trajnime për jetesë të pavarur & jetesë me mbështetje. Trajnime për ngritje kapacitetesh.*

***MEDPAK Shoqata në Mbrojtje të të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara***
Celular: 068 2578002
E-mail: medpak@albmail.com, zelakoka@gmail.com
***Shërbimet: avokati, qëndër ditore, arsim gjithëpërfshirës "Alternativa"***
E-mail: adri@albnet.net
*Shërbimet: qendër burimore për persona me probleme të shëndetit mendor*

***Down Syndrome Albania***
Celular: 0674885864
E-mail: e_zaimi@dsaalbania.org
*Shërbimet: integrim i plotë në shoqëri, pavarësi dhe cilësi e lartë jetese për individët me sindromën Down në Shqipëri.*

***Qendra Jonathan***
Adresa: Rruga "Mihal Duri", Tiranë
Celular: +355 68 20 19 727
E-mail:
info@downsyndromealbania.com
Web:
www.downsyndromealbania.com
*Shërbimet: aftëson fëmijët me Sindromën Down për një jetë të pavarur dhe për t'u integruar në shoqërinë shqiptare me të drejta të plota nëpërmjet terapive të specializuara. Ndërgjegjëson shoqërinë shqiptare për potencialin e këtyre fëmijëve dhe këshillon e informon prindërit e tyre për një mbështetje maksimale të zhvillimit të fëmijëve me Sindromën Down*

***Disabled People Active Albania***
Celular: 0697391552; 0682000324
E-mail: bledi_suxha@gmail.com
***Shërbimet:Active Disabled People Albania (ADP Albania), punon për fuqizimin e personave me aftësi të kufizuar përmes aktiviteteve sportive.***

## VLORË

### Organizatat që punojnë për komunitetin Rom dhe Egjiptian;

***Organizata Një Zë i Barabartë në komunitetin rom dhe egjiptjan***
Celular: 0696240668
*Shërbimet: Mbron të drejtat e komunitetit rom dhe egjiptian*

### Organizatat që punojnë në fushën e aftësisë së kufizuar;

***Shoqata e invalidëve para dhe tetraplegjikë***
Celular: 0696125871
E-mail: hysenmuhameti@gmail.com
*Shërbimet: të drejtat e personave me aftësi të kufizuara para dhe tetraplegjikë*

***Shoqata e të verbërve***
Celular: 065369869
*Shërbimet: të drejtat e personave të verbër*

**Shoqata e Invalidëve të punës Fusha e veprimtarisë: të drejtat e personave invalidë pune.**

### Organizatat që punojnë për gratë

***Qendra psiko - sociale Vatra***
Celular: +355692083339
E-mail: brikena_puka@yahoo.com
*Shërbimet: Mbrojtje dhe asistencë ligjore dhe psikologjike, akomodim në strehëz, ndërmjetësim për kurse profesjonale dhe punësim, ndërmjetësim për shërbime mjekësore falas, trajnime dhe fushata sensibilizuese për gratë, vajzat, burrat e djemtë viktima dhune dhe trafikimi*

***Qendra e zhvillimit të popullsisë Aulona***
Celular: +355689047552
E-mail: qgvlore@aul.com.al
*Shërbimet: Trajnime dhe sensibilizim për çështjet e dhunës e barazisë gjinore, studime për fenomenin e dhunës, barazisë gjinore dhe mbrojtjes së fëmijëve*

## ELBASAN

***Organizatat që punojnë për Komunitetin Rom dhe Egjiptian***
***Qendra Komunitare Rome***
Celular: 0694412826
E-mail: shuli@yahoo.com

***Zëri ROM***
Celular: 696290122
E-mail: esmeralda_el@live.com

***SHAO***
Celular: 0695804046
E-mail: anisa.muka@hotmail.it

***CRCA***
Dritmira Gremi
Celular: 0675248770

**Organizata që punojnë në fushën e aftësisë së kufizuar**

***Future for You***
Celular: 0696689806;
E-mail: linditasenja@gmail.com

***Fluturo për jetën***
Celular: 0682044337
E-mail: belaboci@yahoo.it

***MEDPAK***
Celular: 0692472903
E-mail: xcankja@yahoo.it

***QSHINJNV***
Celular: 0692034261;
E-mail: fatmaspahiu@yahoo.com

***Qendra Balashe***
Celular: 0682099060
E-mail: blerinaduka@yahoo.it

***Save the Children***
E-mail:
anila.meco@savethechildren.org

***FSHDPAK***
E-mail: adrf@albmail.com;
bcani009@gmail.com

***World Vision***
Celular: 0682056563;
E-mail: ilir_gjoni@ëvi.org

**Organizatat që punojnë për Fëmijët dhe Gratë**

***World Vision***
Celular: 0682056563;
E-mail: ilir_gjoni@wvi.org

***Ndihmë për Ballkanin***
Celular: 0694016712;
E-mail:
alketa.hasani@a2balbania.org

***Tjetër Vizion***
Celular: 0695657301

***Forumi i Gruas Elbasan***
Celular: 0694746931
E-mail:
forumigruas1991@gmail.com

***Qendra e Gruas për Zhvillim***
Celular: 0695376982
E-mail: rudinacollaku@hotmail.com

***Food Bank***
Celular: 0692093377

***Ndihma e Wailhailmit***
Celular: 0693254729

***Fondacioni Nënë Tereza***
Motër Faustina
Tel.: 054252803
Drita Krasniqi
Celular: 0693767707;
E-mail:
joscelyn.fondation@gmail.com

**SHKODËR**

**Organizatat që punojnë për komunitetin Rom dhe Egjiptian**

**Organizata Shqiptare e Urdhrit të Maltës (Qendra - Një hap**

**më tej për integrimin e komunitetit Rom dhe Egjiptian në shoqërinë tonë)**
Tel.: 022250447/6
E-mail: maranaj.marku@gmail.com
***ARSIS***
Celular: 0674833248

***TLAS***
Blv. Bajram Curri, Pall.Agimi, Shk.18, Ap.322,Tirana
Celular: 0692093731
E-mail: tlas@tlas.org.al

***Shoqatata "Për të Drejtat e Komunitetit Egjiptian" në bashkëpunim me Romët***
Celular: 0672573255
E-mail: cufiolsi@yahoo.com

***Integrimi i Romeve te Veriut. Projekt për arsimin e fëmijëve në Shkodër***
Celular: 0697297123
E-mail: edison_kipti@live.com

## Organizata që punojnë në fushën e aftësisë së kufizuar

***Organizata Shqiptare e Urdhrit te Maltës (Projekti-Qendra e Këshillimit dhe Shërbimit Malteser)***
022250447/6
E-mail: maranaj.marku@gmail.com

***Qendra e Zhvillimit Shkodër***
Celular: 0686092002

***Shoqata "Komuniteti Papa Xhovani XXIII"***
E-mail: samuel.74@libero.it

***Shoqata Projekti Shpresa Shërbime për personat me aftësi të kufizuara***
Celular: 0682023440
E-mail: progetto.speranza@gmail.com

***Opera della Divina Provvidenza Madonnina del Grappa Shërbime për personat me aftësi të kufizuara***
Celular: 0672862160
E-mail: fabricionocchi@libero.it

***The Door***
Celular: 0682026559
E-mail: thedoor@infothedoor.com
*Promovimi i të drejtave dhe shërbime për personat me aftësi të kufizuara*

***Shoqata Para-Tetraplegjikëve, Dega Shkodër***
Celular: 0682259025

## Organizatat që punojnë për gratë

***Qendra e Gruas "Hapa të Lehtë"***
Celular: 0673118301
E-mail: hapatelehte@gmail.com

***Organizata "Gruaja tek Gruaja"***
Celular: 0682079112

***Mary ward Loreto***
Celular: 0675861013

**Ky materiali u përgatit nga Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara në bashkëpunim me Qëndrën për të Drejtat e Grave Rome dhe Aleancën LGBTI.**

*Për informacion të mëtejshëm mund të kontaktoni me:*

**Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara**
Rr. Bogdani, Nr 1, Tiranë; Tel:+ 35542269426;
E-mail:adrf@albmail.com; www.adrf.al

@ UN WOMEN
Tiranë, Qershor 2018
Ndalohet shitja apo përdorimi i këtij udhëzuesi për qëllime përfitimi

Ky udhëzues u realizua përmes programit Fund Dhunës ndaj Grave në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi “Zbatojmë Standartet, Ndryshojmë Mendësitë” financuar nga Komisioni Evropian dhe zbatuar nga UN Women.
Mendimet e shprehura në këtë studim u përkasin autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e UN Women.